



REPUBLIKA E SHQIPERISE

**BASHKIA SHIJAK
NJESIA E PROKURIMIT**

Data 22.2.2023

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“BLERJE KARBURANT PËR NEVOJA TË BASHKISË SHIJAK ”,

TIPI I KONTRATËS- MALL

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09134100-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

8.333.333(tetëmilion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh, vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, njësia e prokurimit në Bashkinë Shijak ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

“Blerje karburant për nevoja të Bashkisë Shijak ”

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3*; Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është **166,666** (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku xhiroja vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2020,2021,2022), nga data e zhvillimit të procedurës të jetë sa 40 % e vlerës së fondit limit të kësaj kontrate. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar ne nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitetet e duhura për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 e ndryshuar, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoritetit kontraktor, operatori ekonomik duhet të disponojë jo më pak se 2 pika brenda territorit në juridiksion të Bashkisë Shijak.

Për të vërtetuar disponimin operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Nëse pika e tregtimit të karburantit është në pronësi të jetë e pasqyruar në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB;
- Nëse pika e tregtimit të karburantit është me qira duhet të paraqesë kontrate noteriale qeraje.

Pika e tregtimit të karburantit detyrimisht duhet të jetë e pajisur me dokumentacion si më poshtë:

- Licencë lëshuar nga pushteti vendor për tregtim karburantesh me pakicë sipas Ligjit Nr. 8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, me ndryshimet;
- Leje mjedisore përkatëse lëshuar nga QKL;

- Vërtetim teknik për respektimin e normave dhe kushteve teknike në stacionet e tregtimit të karburanteve, lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);
- Çertifikatë e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162., datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5 të VKM nr. 285., datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si edhe referuar Ligjit Nr.8450 dt.24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, me ndryshimet.

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fletë analizë për produktin Gazoil 10 PPM S SH EN 590:2022 dhe për produktin Benzinë Premium Unl 10 ppm S SH EN 228: 2012 + A1: 2017 nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI), shoqëruar me Deklaratën Doganore SAD, i cili duhet të jetë në përputhje me standardet në fuqi dhe ku të jenë qartësisht të përcaktuara të gjitha të dhënat e këtij artikulli, me qëllim krahasimin e tij me specifikimet teknike. Fletë analiza të jetë e lëshuar brenda 30 ditëve nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si edhe referuar Ligjit Nr.8450 dt.24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, me ndryshimet.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhtë:

- Deklaratë se merr përsipër furnizimin me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Karta elektronike duhet të jetë pa afat skadence deri në përfundimin e plotë të kontratës.
- Bazuar në VKM nr. 561, datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme“, Operatori ekonomik ofertues duhet të ofrojë një faqe menaxhimi të karburanteve (ëebpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike.
- Faqja e menaxhimit të karburanteve (ëebpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.

Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara mësipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (Ëebpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si edhe referuar Ligjit Nr.8450

dt.24.02.1999 "Për përpunimin, transportin dhe tregtimin të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", me ndryshimet.

Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, mbajmë në konsideratë përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që: "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Specifikimi i Materialeve:

1. Naftë gazoil-10ppm, sipas Standartit SSHEN 590:2022.

Të dhënat teknike të Gazoil 10 PPM i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar (S SH): Lëndë djegëse për automjete – Karburant diezel (Gazoil) sipas S SH EN 590:2022

Specifikimet teknike të Gazolit (Naftë)

Lëndë djegëse për automjete – Karburant diezel (Gazoil) sipas SSH EN 590:2022

Kërkesa të përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provave

Treguesi cilësor	Njësia e matjes	Normat e lejuara		Metoda e provës
		minimale	maksimale	
Numri i cetanit ^b		51,0	-	EN ISO 5165
Indeksiicetanit		46,0	-	EN ISO 4264
Densiteti në 15 °C ^c	kg/m ³	820	845	EN ISO 3675 EN ISO 12185
Hidrokarburët aromatikë policiklikë ^{d,e}	% (m/m)	-	11	EN 12916
Përmbajtja e squfurit ^f	mg/kg	-	deri 10.0 (01.01.2009)	EN ISO 20846 EN ISO 20884
Pika e flakërimit	°C	mbi 55	-	EN ISO 2719
Përmbajtja e koksit ^g (në 10 % mbetjedistilimi)	% (m/m)	-	0,30	EN ISO 10370

Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,01	EN ISO 6245
Përmbajtja e ujit	mg/kg	-	200	EN ISO 12937
Ndohtja e përgjithshme	mg/kg	-	24	EN 12662
Korrozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)	vlerësim	klasa 1		EN ISO 2160
Stabiliteti ndaj oksidimit	g/m ³	-	25	EN ISO 12205
Vetitë lubrifikuese, diametri i korrektuarin jollësëg ripuar (gërryer) (ësd 1,4) në 60 °C	µm	-	460	EN ISO 12156-1
Viskoziteti në 40 °C	mm ² /s	2,00	4,50	EN ISO 3104
Distilimi ^{h,i} distilati që vlon ÷ në 250°C, % (v/v) distilati që vlon ÷ në 350 °C, % (v/v) distilati që vlon në 95 % (v/v)	% (V/V) % (V/V) °C	85	< 65 360	EN ISO 3405

2. Benzinë Premium Unl 10 ppm sipas Standartit S SH EN 228: 2012 + A1: 2017:

Kërkesa të përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provave

Nr	Treguesit cilësor	Njësia e matjes	Metoda e Testit	Kërkohe
1	Numri i oktanit kërkimor NOK		EN 25164-1993 ASTM D 2699	Mbi 95
2	Numri i oktanit motorik NOM		EN 25163-1993 ASTM D 2700	Mbi 85
3	Përmbajtja e squfurit	mg/kg	EN ISO 20846	Maksimumi 10
4	Densiteti në 15° C	kg/m ³	EN ISO 3675 ASTM D 4052	Min. 720 – Max. 775
5	Korozioni i shufrës së bakrit (3 ore/50° C)	Renditja	Klasi 1	S SH EN ISO 2160
6	Pamje jashtme	E pastër e tejdukshme	Pamje vizuale	
7	D I S T I L I M I			
A	Distilat deri 70°C	% (v/v)	EN/ISO 3405:1998 ASTM D 86	Min. 20- Max. 48

B	Distilat deri 100°C	%(v/v)	EN/ISO 3405:1998 ASTM D 86	Min. 46- Max.71
C	Distilat deri 150°C	%(v/v)	EN/ISO 3405:1998 ASTM D 86	Min. 75
D	Pika finale e vlimit	°C	EN/ISO 3405:1998 ASTM D 86	Max 210
E	Mbetjet e distilimit	%(v/v)	EN/ISO 3405:1998 ASTM D 86	Max 2
8	Përmbajtja e tipit të hidrokarburit		Sipas standardit në RSH	
9	Përmbajtja e benzinës	%(v/v)	ASTM D 6277	Max.1
10	Përmbajtja e oksigjenit	%(v/v)	ASTM D 5845	Max.2.7
11	Përmbajtja e komponentëve oksigjenore		Sipas standardit në RSH	

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Operatori ekonomik duhet të garantojë furnizim 24 orë pa ndërprerje.
- Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën që kur e gjykon të nevojshme të kërkojë kontrollin e cilësisë së karburantit. Shpenzimet për kontrollin, të përballohen nga operatori ekonomik.
- Furnizimi i karburantit do të bëhet me karta elektronike për çdo automjetet të Bashkisë Shijak sipas kërkesës të Autoritetit Kontraktor.

Grafiku i lëvrimit të karburantit

- Afati kohor për furnizim me karburant do të jetë 1 vit nga data e lidhjes së kontratës .
- Vlefshmëria e kartës elektronike do të jetë edhe pas mbarimit të afatit të kontratës, deri në përfundim të sasisë së karburantit.

NJËSIA E PROKURIMIT

Albiona Mehmeti
Helidon Kalleshi
Arjan Calliku